



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 30/2021 (JR)
Datë 02.06.2021

Vendim nr. 29 (JR)
Datë 07.10.2021

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Natasha Mulaj	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 07.10.2021, ditën e enjte, ora 12:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonči Petković, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 374, datë 23.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Shkëlqim Miri.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e parashtruara

nga Komisioneri Publik, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e pikës 1 të dispozitivit të vendimit nr. 374, datë 23.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke e kategorizuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Shkëlqim Miri, si çështje të papërfunduar për efekt të juridiksionit të rivlerësimit, në mungesë të subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Miri, i cili edhe pse ishte njoftuar rregullisht për seancat gjyqësore, nuk paraqiti ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim: "Komisioni"), me vendimin nr. 374, datë 23.04.2021, ka vendosur: *të deklarojë të ndërprerë procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Shkëlqim Miri, për shkak të humbjes së statusit të magjistratit, pasi është dënuar me vendim penal të formës së prerë.*
2. Komisioni arsyeton se, pasi u njoh me vendimin nr. 529, datë 27.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim "KLGj") për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, z. Shkëlqim Miri, për shkak të dënimit me vendim të formës së prerë, faktin që kundër vendimit të KLGj-së nuk është ushtruar ankimi, si dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk gëzonte më statusin e magjistratit, ka vlerësuar të ndërpresë procesin e rivlerësimit kalimtar për të.

II. Ankimi i Komisionerit Publik

3. Kundër vendimit nr. 374, datë 23.04.2021, të Komisionit, ka ushtruar ankimi Komisioneri Publik, i cili kërkon që ky vendim të merret në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, në mënyrë alternative të vendosë: *ndryshimin e pikës 1 të dispozitivit të vendimit ose lënien në fuqi të tij.*
4. Përmes këtij ankimi, Komisioneri Publik sjell në vëmendje të Kolegjit se Komisioni në vendimmarrjen e tij, *për raste të ngjashme, duke arsyetuar me të njëjtën bazë ligjore, nenin 140 të Kushtetutës, nenin 64, pika 1, germa "ç" e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në vendimin nr. 316/2020 që i përket subjektit të rivlerësimit I. H. ka vendosur "përfundimin e procedurës pa vendim përfundimtar për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit", ndërsa në vendimin nr. 374/2021, objekt ankimi, ka vendosur "ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Shkëlqim Miri, për shkak të humbjes së statusit pasi është dënuar me vendim të formës së prerë".*
5. Për sa parashtuar në ankim, *në rrethanat kur Kolegji nuk ka shprehur ende qëndrimin e tij mbi ankimin e Komisionerit Publik kundrejt vendimit të Komisionit nr. 316/2020, që i përket subjektit I. H., si dhe në rastin kur në momentin e shqyrtimit të ankimit, vendimi i dhënë do të jetë në dritën e dhënies së vendimeve orientuese në kuadër të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme mbi nevojën për saktësimin e dispozitivit në*

pikën 1 të tij. Në të tilla rrethana, orientimi që pritet të japë Kolegji, në vendimin e tij përfundimtar për ankimin e Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 316/2020, eventualisht do të ketë ndikim edhe në shqyrtimin gjyqësor të ankimit konkret të Komisionerit Publik.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

6. Subjekti i rivlerësimit Shkëlqim Miri, për shkak të funksionit si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, si dhe të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
7. Komisioni, pas shortit të hedhur më datë 16.12.2019, administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, dhe nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016.
8. Në kuadër të komunikimeve me Këshillin e Lartë Gjyqësor, lidhur me statusin e magjistratit të subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Miri, Komisioni është njoftuar për vendimin nr. 529, datë 27.10.2020, të KLGj-së “Për caktimin e masës disiplinore”, me të cilin është vendosur:
1. Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. 2. Shkarkimin nga detyra të magjistratit Shkëlqim Miri, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë. 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit, në Gjykatën Kushtetuese [...]. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk është ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, sipas parashikimeve të nenit 179, pika 7 e Kushtetutës¹, nenit 147, pika 1 e ligjit nr. 96/2016², si dhe nenit 5, pika 3, germa “b” e ligjit nr. 84/2016³, në kuadër të juridiksionit disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”).
9. Komisioni, në vijim, me vendimin nr. 374, datë 23.04.2021, mbështetur në pikën 6 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në pikën 2/b të nenit 140⁴ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në germën “ç”, pika 1 e nenit 64 të ligjit nr. 96/2016⁵ “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative⁶, vendosi *të deklarojë të ndërprerë procesin e rivlerësimit kalimtar, për subjektin e rivlerësimit*

¹ Neni 179, pika 7 e Kushtetutës: “[...] Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë”.

² Neni 147, pika 1 e ligjit nr. 96/2016: “1. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për masë disiplinore në gjykatën kompetente”.

³ Neni 5, pika 3, germa “b” e ligjit nr. 84/2016: “Kolegji i Apelit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: [...] b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë”.

⁴ Neni 140, pika 2, germa “b” e Kushtetutës: “2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: [...] b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi”.

⁵ Neni 64, pika 1, germa “ç” e ligjit nr. 96/2016: “1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: [...] ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji”.

⁶ Neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative panjë vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Shkëlqim Miri, për shkak të humbjes së statusit të magjistratit, pasi është dënuar me vendim penal të formës së prerë.

10. Komisioneri Publik ka ushtruar ankim kundër vendimit të Komisionit, duke kërkuar që Kolegji të vendosë në mënyrë alternative *ndryshimin e pikës 1 të dispozitivit të vendimit nr. 374, datë 23.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose lënien në fuqi të tij*, dhe në bisedimet përfundimtare, në ndryshim nga kërkitimi që kishte bërë fillimisht në ankim, ka kërkuar *ndryshimin e pikës 1 të dispozitivit të vendimit nr. 374, datë 23.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke e kategorizuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Shkëlqim Miri, si çështje të papërfunduar për efekt të juridiksionit të rivlerësimit.*
11. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi kontrolloi vendimin nr. 374, datë 23.04.2021, të Komisionit, konstaton se ky vendim për të ndërprerë procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, është i gabuar, pasi arsyet e përfundimit të procesit të rivlerësimit nuk përputhen me institutin e ndërprerjes, i cili është parashikuar nga neni "G", pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si pasojë ligjore vetëm në rastet kur subjektet e rivlerësimit japin dorëheqjen nga detyra, shoqëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndalimin e subjektit të rivlerësimit, për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas kësaj dispozite kushtetuese.
12. Referuar vendimit të Komisionit, bazuar në faktet e provuara përgjatë gjykimit, ka rezultuar se ndërprerja e procesit të rivlerësimit sipas Komisionit, është kryer pasi subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit, për shkak se është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një krimi, pra, po sipas Komisionit, statusi i magjistratit të subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Miri nuk ka përfunduar për shkak të dorëheqjes nga detyra, por për shkak të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, dhënë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.
13. Referuar ankimit të Komisionerit Publik, si dhe në analizë të vendimit nr. 316, datë 17.11.2020, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit I. H., vendim i cili është dhënë më parë në kohë nga Komisioni se vendimi objekt shqyrtimi që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Miri, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në arsyetimin e vendimit të parë, atij me nr. 316, datë 17.11.2020, baza ligjore e përdorur nga Komisioni në pjesën arsyetuese përkon me zgjidhjen që i është dhënë çështjes në pjesën urdhëruese të vendimit, në të cilën është deklaruar përfundimi i procedurës administrative pa vendim përfundimtar, sipas përcaktimit në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative.
Lidhur me vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Miri, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në këtë vendim, në ndryshim të hapur me vendimin që Komisioni për një situatë të ngjashme faktike kishte marrë disa muaj më parë për subjektin e rivlerësimit Ibrahim Hoxha, kanë gjetur zbatim për zgjidhjen e çështjes dy institute ligjore të ndryshme, pasi rezulton se në pjesën arsyetuese të vendimit është përdorur si bazë ligjore neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative, *përfundimi i procedurës administrative pa një vendim përfundimtar*, ndërsa në pjesën urdhëruese të vendimit është disponuar me *ndërprerje të procesit të rivlerësimit*, që aplikohet vetëm në rastet e institutit të dorëheqjes nga detyra, të parashikuar nga neni G i Aneksit të Kushtetutës.

14. Meqenëse procedura administrative zhvillohet në Komision, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në kuptim të nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni do të duhej në të tilla rrethana faktike, të deklarojë të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar, me arsyetimin se subjekti i rivlerësimit e ka humbur statusin e magjistratit për shkak të shkarkimit nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
15. Në mbështetje të sa më sipër, vendimi i dhënë nga Komisioni, haptazi ka kontradiktë mes pjesës arsyetuese dhe pjesës urdhëruese të tij dhe në këtë rast, trupi gjykues i Kolegjit çmon se ky vendim është jo vetëm i kundërligjshëm, por edhe alogjik, që nuk mund të sjellë pasoja juridike të ligjshme dhe, si i tillë, ai nuk mund të lihet në fuqi.
16. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimet e Komisionit duhet të jenë të plota dhe të qarta, ku pjesa arsyetuese dhe pjesa urdhëruese duhet të jenë në harmoni me njëra-tjetrën dhe jo të vijnë në kontradiktë të hapur si në rastin konkret, pasi pjesa urdhëruese e vendimit vjen si rrjedhë logjike e analizës që i bëhet situatës faktike të konstatuar nëpërmjet provave të marra në gjykim dhe zbatimit të bazës së duhur ligjore mbi këto fakte, pasi domosdoshmëria e arsyetimit të plotë dhe të qartë të vendimeve gjyqësore, është garanci për procesin e rregullt ligjor.
17. Ndodhur në këtë situatë faktike dhe ligjore, kur vendimi i Komisionit është marrë në interpretim të gabuar të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Përrivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, trupi gjykues vlerëson se ky vendim duhet të prishet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 374, datë 23.04.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Miri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 07.10.2021.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi - kundër

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi - kundër

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtaret Rezarta Schuetz dhe Ina Rama, votuam kundër shumicës në vendimin me objekt ankimin e Komisionerit Publik në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Miri. Komisioneri Publik kërkoi nga Kolegj të merrte në shqyrtim vendimin e Komisionit [me nr. 374, datë 23.04.2021] dhe në mënyrë alternative të vendoste *ndryshimin e pikës I të dispozitivit të vendimit ose lënien në fuqi të tij* – në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016. Shumica vendosi prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pa u shprehur për fatin e mëtejshëm të kësaj çështjeje apo pa udhëzuar Komisionin për hapat që duhen ndërmarrë në çështjen konkrete, për të disponuar për procesin e rivlerësimit të këtij subjekti.
2. Në vlerësimin e shumicës, vendimi i Komisionit duhej të prishej sepse teksa ka urdhëruar *ndërprerjen* e procesit të rivlerësimit për subjektin Shkëlqim Miri, në përmbajtje [vendimi objekt analize] është shprehur *për përfundimin pa një vendim përfundimtar*. Argumenti kryesor për këtë disponim të shumicës, është tërësisht i bazuar në faktin që në kushtet kur procesi për subjektin Shkëlqim Miri ka përfunduar për shkak të humbjes së statusit të magjistratit, nuk kishte vend të zbatohet instituti i ndërprerjes, por do të duhej të ishte zbatuar përfundimi i procesit pa vendim përfundimtar. Ky qëndrim bazohet në faktin që ndërprerja – një pasojë ligjore e dorëheqjes nga detyra – shoqërohet me ndalimin për subjektet përkatëse, për t'u emëruar në pozicione të caktuara në sistemin e drejtësisë.
3. Ky këndvështrim bie ndesh me logjikën dhe me një analizë harmonike të dispozitave ligjore për disa arsye. Së pari, ky disponim i shumicës nuk i jep përgjigje vijueshmërisë së procesit për këtë subjekt rivlerësimi, duke e bërë minimalisht të nevojshme ripërsëritjen e një procesi administrativ në Komision, për shkak të mënyrës formaliste të interpretimit nga shumica, me pasojë tejzgjatjen e procesit për këtë subjekt, që ishte e evitueshme. Kjo tejzgjatje e procesit, që merr shkak kryekëput nga përdorimi pasaktësisht i një termi [ndërprerje] nga Komisioni, mund të ishte evituar nëse në përputhje me nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji do t'i jepte orientim Komisionit për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, duke ndryshuar vendimin.

Së dyti, subjekti i rivlerësimit Shkëlqim Miri ka humbur statusin e magjistratit përfundimisht nëpërmjet vendimit të KLGj-së nr. 529, datë 27.10.2020, që ka vendosur mbi bazën e nenit 140, pika 2, germa “b” e Kushtetutës dhe neneve 104, pika 3 dhe 111 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar. Ky vendim i KLGj-së është marrë në kushtet kur subjekti ishte dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, në datën 27.02.2019, pasi Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda të datës 27.11.2018, sipas të cilit z. Miri është deklaruar fajtor për veprën penale të korrupsionit pasiv dhe është dënuar me burgim. Rezulton që vendimi i KLGj-së që deklaroi humbjen e statusit nga subjekti i rivlerësimit Shkëlqim Miri, është në fuqi. Vlen të theksojmë që subjekti i rivlerësimit kishte kërkuar edhe dorëheqjen nga detyra e gjyqtarit më datë 08.04.2019, përreth 18 muaj përpara se KLGj-ja të vendoste humbjen e statusit të magjistratit prej subjektit. Rezulton se më datë 09.04.2019, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, me anën e të cilit ka kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave dhe deklarimin të pafajshëm. Nga faqja zyrtare në internet e Gjykatës së Lartë, çështja rezultonte në proces studimi në momentin kur trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim këtë ankim.

4. Nga ana tjetër, subjekti nuk paraqiti asnjë kundërshtim ndaj vendimit të KLGj-së, as në gjykimin në Kolegj, megjithëse u njoftua për seancat gjyqësore që do të zhvilloheshin për gjykimin e kësaj çështjeje, dhe as nuk parashtroi prapësime që do të kontestonin vendimmarrjen e shkarkimit as para Kolegjit, si gjykata e vetme sot që ka juridiksion për shqyrtimin e vendimeve të këshillave gjyqësorë e të prokurorisë në rastet e vendosjes së masave disiplinore ndaj magjistratëve. Nga kjo analizë, rezulton se në datën 23.04.2021, në të cilën është marrë vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit kishte humbur statusin e magjistratit në vijim të vendimit të KLGj-së me nr. 529, datë 27.10.2020, i cili ka shkarkuar subjektin nga detyra e gjyqtarit për shkak të dënimit të tij për kryerjen e një krimi me vendim penal të formës së prerë. Ky vendim i organit kompetent, i cili ka shkaktuar edhe mbarimin e statusit për subjektin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 64, pika 1, germa “ç” e ligjit nr. 96/2016, ka marrë formë të prerë dhe nuk rezulton të jetë kundërshtuar prej tij në rrugë gjyqësore apo administrative sipas legjislacionit në fuqi.
5. Në këto kushte, Kolegji konstaton se situata faktike e cila i është nënshtruar vlerësimit të Komisionit, nuk ka pasur asnjë ekuivok në drejtim të sigurisë së faktit se subjekti i rivlerësimit e kishte humbur statusin e magjistratit dhe asnjë çështje nuk gjendej e varur për të zgjidhur ndonjë pretendim rreth kësaj situatë. I gjithë procesi i rivlerësimit është konceptuar dhe miratuar që t’i shërbejë qëllimit kushtetues të pastrimit të radhëve të magjistratëve nga individë që nuk e gëzojnë besimin e publikut dhe, si i tillë, do të duhet të përfshijë të gjithë ata që janë pjesë e sistemit të drejtësisë. Ky proces nuk është parashikuar të jetë *per se* një qëllim edhe për ata që nuk janë më pjesë e këtij sistemi. Qëllimi kushtetues në këto raste është realizuar nëpërmjet mekanizmave të tjerë ligjorë, siç është në këtë rast, shkarkimi i subjektit nga detyra e gjyqtarit për shkak të dënimit me një vendim penal për kryerjen e një krimi.
6. Në vlerësimin tonë, nëse në të ardhmen kjo situatë faktike do të ndryshojë për shkak të një disponimi në mbështetje të rekursit të depozituar prej subjektit në Gjykatën e Lartë, lidhur me vendimin penal të dënimit të tij, rikthimi i tij në detyrë dhe rifitimi i statusit të magjistratit do të ishin ngjarje krejt hipotetike të cilat do të vareshin mbi një sërë faktorësh që lidhen si me vullnetin e subjektit, por edhe me zbatimin e legjislacionit relevant që do të zgjidhte çështjen. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se pretendimi i Komisionit Publik se duhet gjykuar vendimi i Komisionit mbi ngjarje që mund të ndodhin në të ardhmen, është i padrejtë dhe i pambështetur në dispozitat procedurale administrative që përcaktojnë kufijtë dhe fushën e kontrollit të vendimeve të organeve administrative prej gjykatës. Neni 37, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 parashikon se: *Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ*, për pasojë çdo pretendim që mund të ngrihet në të ardhmen rreth sigurisë së ekzistencës së kësaj gjendjeje juridike, për shkak të ngjarjeve që mund të ndodhin, sipas vlerësimit të Kolegjit, në kontekstin e situatës faktike të përshkruar më lart, nuk i përket vendimmarrjes së organeve të rivlerësimit në kuptim të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi.
7. Qëndrimi ynë përkon me jurisprudencën e Kolegjit në çështje të tjera, në të cilat subjektet e rivlerësimit kanë humbur statusin e magjistratit. Fokusuar në faktin që vendimi i organeve përkatëse [KLGj apo KLP] për humbjen e statusit ka marrë formë të prerë, trupa gjyqësore të

ndryshëm të Kolegjit, kur kanë konstatuar humbjen e statusit të magjistratit, kanë disponuar me dispozitivët përkatës.

8. Në vijim të këtij arsytimi dhe në konsideratë të situatës faktike, sjellim në vëmendje që Kolegji shqyrtoi dhe analizoi vendimin e Komisionit në drejtim të zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi dhe, nga kjo analizë, nuk konstatoi shkeljen e asnjë prej tyre. Subjekti i rivlerësimit Shkëlqim Miri e ka fituar statusin e magjistratit në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, që parashikojnë zhvillimin e procesit të rivlerësimit *ex officio* për këtë kategori. Humbja e statusit të magjistratit me vendim të formës së prerë të organit kompetent, kushtëzon edhe humbjen e statusit të subjektit të rivlerësimit sipas dispozitave të cituara, e për pasojë rrëzon vetë objektin e procesit të rivlerësimit, i cili synon rivlerësimin e subjekteve sipas kategorizimit të më lart cituar.

9. Në konsiderim të konkluzioneve të arritura për çështjet më sipër, vlerësuam se në kushtet kur procesi i rivlerësimit për ish-magjistratin Shkëlqim Miri, ka mbetur pa objekt dhe e ka humbur qëllimin, për sa kohë që qëllimi kushtetues i kthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë nëpërmjet pastrimit të radhëve të magjistratëve nga ata që nuk e gëzojnë këtë besim, është arritur gjithësesi nëpërmjet shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet një juridiksioni tjetër kushtetues, Komisioni, në momentin që ka nisur procedurat administrative për kryerjen e këtij procesi, me të drejtë ka marrë në konsideratë këtë situatë dhe dispozitat ligjore të cituara më lart.

Për sa më sipër, votuam kundër arsytimit të shumicës në vendimin në fjalë, duke votuar për ndryshimin e vendimit të komisionit, i cili duhej të kishte deklaruar të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar.

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi